



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 69, datë 30.12.2019

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS
KANALIZIME ROSKOVEC SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 39**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 40**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 41**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura" (**Vendimi nr. 42**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 30.12.2019 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësajllës Kanalizime Roskovec sh.a për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

Vëren se:

1. Shoqëria "Ujësajllës Kanalizime Roskovec" (**UK Roskovec**) me shkresë nr. 165 prot. datë 29.06.2018 "**Dokumentacion për aplikimin për nivel të ri të tarifave**" ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rritjen e tarifave në zonën e shërbimit për të tre kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe Vendimin nr. 40.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifës fikse të shoqërisë UK Roskovec në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me Vendimin Nr. 79 datë 26.11.2018 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Roskovec për nivelin e ri tarifor për

shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM nr. 63 dt. 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

3. Ujësjetës Kanalizime Roskovec ka paraqitur dokumentacionin e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU me shkresë nr. 165 prot. datë 29.06.2018 “*Dokumentacion për aplikimin për nivel të ri të tarifave*” për të tre kategoritë e konsumatorëve sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me Tarifat Aktuale dhe të Propozuara nga Shoqëria sipas Kategorisë së Konsumatorëve

Kategoritë e Konsumatorëve	Tarifat viti 2017				Tarifat e Propozuara	
	NJA Roskovec	NJA Kurjan	NJA Strum	NJA Kuman	Zona e Riorganizuar	
Shërbimi i furnizimit me ujë						
A. Tarifë Volumetrike për klientët me matës	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	Lek/m3	
1. Konsumatorë Familjarë	52	60	50	50	52	
2. Konsumatorë Publik	105	60	50	50	105	
3. Konsumatorë Privat	125	60	50	50	125	
B. Tarifë Aforfe Shërbimi i furnizimit me ujë	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	
1. Konsumatorë Familjarë (20 m ³ *52 lekë)					1,040	
2. Konsumatorë Publik (80 m ³ * 105 lekë)					8,400	
3. Konsumatorë Privat (50 m ³ *125 lekë)					6,250	
C. Tarifë uji i ndotur (aforfe)	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	
1. Konsumatorë Familjarë	42	42			50	
2. Konsumatorë Publik	0	0			200	
3. Konsumatorë Privat	83	0			200	
D. Tarifë Fikse UK	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	
					FU	KUN
1. Konsumatorë Familjarë	200	100			100	50
2. Konsumatorë Publik	200	100			100	100
3. Konsumatorë Privat	200	100			100	100

Shoqëria për vitet 2018-2019 aplikon në të gjithë zonën e shërbimit nivelin tarifor të propozuar aktualisht pranë ERRU-së, me justifikimin e opinionit pozitiv që ka dhënë Këshilli Bashkiak Roskovec për këtë propozim, shprehur në Vendimin nr. 81 datë 18.10.2018.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se treguesit e arritur të performancës për vitin 2018 (i mbyllur), Vitin 2019 (i pritshëm) dhe objektivat e propozuara nga shoqëria UK Roskovec për vitin 2020 janë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me Treguesit Kryesorë të Performancës Sipas Shoqërisë për Vitet 2018-2020

Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Treguesit e Performancës sipas Shoqërisë		
		Viti 2018 (I Mbyllur)	Viti 2019 (I Pritshëm)	Viti 2020 (Parashikimi)
Mbulimi i Kostove Direkte të O&M	%	64	68	75
Uji Pa të Ardhura	%	67.5	65.3	62.3
Mbulimi me Ujë	%	31	32	35
Mbulimi me KUN	%	20	20	22
Niveli i Matjes	%	86	92	92
Norma e Arkëtimit Korrente	%	69	69	80
Norma e Arkëtimit e Përgjithshme	%	72	87	100
Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	5	5	7
Efiçenca e stafit	staf/1000 lidhje UK	12.3	13.6	11.2

Nevoja e ndryshimit të tarifave sipas UK Roskovec argumentohet si më poshtë:

- a) Në zbatim të VKM nr. 63 dt. 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.”, UK Roskovec është shoqëri e re dhe aplikon për herë të parë.
 - b) Unifikimi i tarifave për të gjithë zonën duke qënë se shoqëria ka trashëguar tarifat e zonave që me parë janë shërbyer nga UK Fier
 - c) Përmirësimin e nivelit aktual të mbulimit të kostove O&M, kryesisht nga menaxhimi, shtimi i lidhjeve dhe rritja e nivelit të faturimit.
 - d) Përmirësimin i treguesit staf/1000 lidhje UK nëpërmjet reduktimit të stafit nga 61 punonjës për vitin aktual 2019 në 55 punonjës për vitin 2020 (parashikimi).
5. ERRU, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në Vendimin nr.42, ka kërkuar nga UK Roskovec informacion shtesë si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.
6. ERRU, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Roskovec të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar (**ligji nr. 9121**), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;
 - c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve” i ndryshuar (**ligji nr. 9902**);

- d) Orientimin drejt Mbulimit të kostove O&M pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që tentojnë mbulimin e këtyre kostove.
- e) Tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi **përballueshmërinë**, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme.
- f) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.
- g) Propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar.
7. ERRU, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:
- a) Shoqëria UK Roskovec si një shoqëri e re, relativisht e vogël duhet të bëjë përpjekje që në një afat trevjeçar të mund të realizojë një Plan Biznesi 5 vjeçar.
- b) Brenda vitit 2020 të gjithë klientët jo familjar të jenë të pajisur me matësa.
- c) Shoqëria duhet të forcojë angazhimin për të patur një informacion sa më të plotë dhe të saktë.
- d) Shoqëria duhet të hartojë një plan konkret veprimi me qëllim arkëtimin e debive të prapambetura dhe për pjesën e debisë pa shpresë kthimi pas analizës së secilit klient dhe duhet të ndjek hapat ligjor me qëllim pastrimin e tyre nga bilanci pjesë-pjesë nëpërmjet planifikimit të provizioneve të shpërndarë në vite.
- e) Për të hartuar Bilancin e Ujit sa më real, në të gjithë nën zërat e tij, duhet të konsiderojë:
- Të pajisë me matësa të mëdhenj të gjitha pikat e prodhimit të ujit në të cilat prodhimi ende vlerësohet, gjithashtu të vendosë matësa dhe në pikat kryesore të rrjetit.
 - Gjatë periudhës që shoqëria nuk ka të instaluar matësa në prodhim, duhet të mbajë regjistra ku të pasqyrohet sasia ditore e ujit që prodhohet. Për vlerësimin e ujit të prodhuar të bazohet edhe në matjet e regjistruara në depot apo rezervuarët të cilat janë të pajisur me aparate ujëmatës.
 - Të organizohet dhe të forcojë angazhimin në eliminimin e lidhjeve të paligjshme nëpërmjet task-forcës për të përmirësuar treguesin UPA.
 - Të mbajë evidenca mbi defektet e ndodhura gjatë vitit në sistemin e furnizimit, të përlllogaritë sasi të humbura të ujit para riparimit dhe gjatë riparimit.
 - Të evidentojë me saktësi dhe të zëvendësojë tubacionet në segmentet me humbje të mëdha.
 - Të mbajë nën kontroll të gjithë sistemin për të reaguar në kohën e duhur ndaj defekteve për të minimizuar humbjet nga rrjedhjet.
- f) Shoqëria deri në fund të vitit 2020 të ketë grumbulluar dhe saktësuar dokumentacionin teknik lidhur me asetet që përbëjnë sistemet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura që administrohen prej saj, në veçanti për tubacionet duke plotësuar të dhënat për gjatësitë, vitin e ndërtimit, diametrin dhe materialin e përdorur.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me Vendim nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura" si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përballeshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, "Për mbrojtjen e Konkurrencës", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 "Për mbrojtjen e Konsumatorëve", për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22 të ligjit nr.8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Roskovec si më poshtë:

Kategoria e Klientëve	Furnizimin me Ujë		Kanalizimi i Ujërave të Ndotur	
	Tarifë Volumetrike	Tarifë Fikse	Tarifë Volumetrike	Tarifë Fikse
	Lek/m3	Lek/muaj	Lek/m3	Lek/muaj
Klientë Familjarë	52	100	15	50
Klientë Publik	105	100	20	50
Klientë Privat	125	100	20	50

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës të vitit 2020 për Shoqërinë UK Roskovec të jenë:

Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Niveli i Objektivit të Përcaktuar nga ERRU
Mbulimi i Kostove O&M	%	79
Uji pa të ardhura	%	60
Niveli i Matjes	%	92
Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	7
Efiçenca e Stafit	staf/1000 lidhje	11.2
Mbulimi me Ujë	%	35
Mbulimi me KUN	%	22
Norma e Arkëtimit Korente	%	80
Norma e Arkëtimit Përgjithshme	%	100

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Roskovec sh. a do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Roskovec brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4 të nenit 22 të ligjit nr. 8102.

5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 01.02.2020 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Ndriçim Shani